

Komisioni Evropian në kuadër të programit "Evropa Kreative (Kultura)" shpalli Thirrjen për mbështetje të sektorit kulturor dhe kreativ ukrainas - CREA-CULT-2025-COOP-UA, me afat kohor për dorëzimin e propozim-projekteve deri më 6 shkurt 2025 deri në orën 17:00 (sipas kohës së Evropës Qendrore)

Thirrja synon të mbështesë sektorin kulturor të Ukrainës duke financuar projekte që do të lidhin organizatat kulturore ukrainase me ato nga vendet e tjera që marrin pjesë në programin "Evropa Kreative". Kjo thirrje është pjesë e planit gjithëpërfshirës të BE-së për të mbështetur Ukrainën me theks në rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të resurseve kulturore. Kjo mbështetje synon të ndihmojë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe të ofrojë mbështetje për artistët dhe organizatat, por edhe të inkurajojë integrimin e tyre në hapësirën më të gjerë kulturore evropiane. Në aspekt afatgjatë, kjo nismë do të kontribuojë në rimëkëmbjen sociale dhe kulturore të Ukrainës, në veçanti do të forcojë bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar që kapërcen kufijtë dhe kontribuon në paqen dhe unitetin e qëndrueshëm.

Qëllimet dhe prioritetet

Qëllimet e thirrjes bazohen në tre prioritate kyçe, që përcaktohen si njësi të ndryshme tematike, përkatësisht:

TEMA 1: Mbështetje për artistët dhe organizatat kulturore ukrainase (CREA-CULT-2025-COOP-UA-1) – financimi i projekteve të përbashkëta midis artistëve ukrainas dhe organizatave kulturore nga vendet e BE-së për të prezantuar veprat e tyre dhe për të forcuar bashkëpunimin.

TEMA 2: Sigurimi i qasjes për qytetarët ukrainas në kulturën dhe trashëgiminë kulturore (CREA-CULT-2025-COOP-UA-2) – financimi i aktiviteteve që synojnë përfshirjen sociale dhe integrimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur përmes iniciativave kulturore.

TEMA 3: Përgatitja për rimëkëmbjen e sektorit kulturor të Ukrainës (CREA-CULT-2025-COOP-UA-3) – aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e rrjeteve që do të mbështesin sektorët kulturorë në përgatitjen për rimëkëmbjen dhe forcimin e qëndrueshmërisë sociale.

Çdo projekt mund të propozohet vetëm brenda një teme kurse qëllimi është financimi i projekteve që kontribuojnë në prioritetet specifike. Çdo temë ka aktivitete specifike.

TEMA 1 ■ TEMA 2

Mbështetja përmes financimit të palëve të treta (grante kaskade) – të paktën 70% e shumës së përgjithshme të mbështetjes së BE-së duhet të drejtohet në mbështetje financiare për palët e treta në Ukrainë. Ky financim mund të jetë në formën e bursave, mbështetjes për organizata ose të ngjashme dhe do të shpërndahet përmes të paktën katër thirrjeve publike gjatë kohëzgjatjes së projektit.

Informacione dhe mbështetje për aplikantët – kjo përfshin aktivitete: sesione informimi, ofrimi i ndihmës dhe këshillimit për aplikim, me qëllim rritjen e disponueshmërisë së fondeve për organizatat dhe artistët ukrainas.

TEMA 3

Ngritja e kapaciteteve dhe rrjetëzimi – aktivitetet e projektit përfshijnë punëtori, seminare, studime dhe misione për të forcuar kapacitetin e sektorit, me aktivitete shtesë të rrjetëzimit që lidhin artistët ukrainas me kolegët nga vendet pjesëmarrëse të Evropës Kreative.

Korniza buxhetore dhe financiare

Buxheti i përgjithshëm i thirrjes është 5 milionë euro dhe ndahet në tre tema:

- TEMA 1: Shuma maksimale e mbështetjes nga BE-ja është 2 milionë euro;
- TEMA 2: Shuma maksimale e mbështetjes nga BE është gjithashtu 2 milionë euro;
- TEMA 3: Shuma maksimale e mbështetjes nga BE-ja është 1 milion euro.

Shuma e përgjithshme e financimit për projekt mund të arrijë në 90% të shpenzimeve të pranueshme ndërsa 10% e mbetur janë shpenzim i aplikantëve. Kohëzgjatja e projekteve është 36 muaj.

Aplikuesit e kualifikuar

– Konsorcium që duhet të përfshijë të paktën dy organizata, njëra prej të cilave duhet të jetë nga Ukraina dhe tjetra nga një vend pjesëmarrës i Evropës Kreative.

– Aplikantët duhet të jenë persona juridikë (privat ose publikë), ndërsa personat fizikë nuk janë të kualifikuar për të marrë pjesë, përveç rasteve kur janë të vetëpunësuar.

– Organizatat brenda konsorciumit duhet të tregojnë kapacitete financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit.

Ndikime të pritura

- Forcimi i bashkëpunimit kulturor midis Ukrainës dhe vendeve të tjera të Evropës Kreative, duke u mundësuar organizatave kulturore nga Ukraina të lidhen me partnerë ndërkombëtarë, të ndajnë njohuritë dhe të ndërtojnë partneritete afatgjata.
- Qasja në kulturë dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore për ukrainasit, duke përfshirë të zhvendosurit në Ukrainë ose refugjatët në vende të tjera të BE-së. Kultura do të shërbejë si mjet i kohezionit social dhe mbështetjes së shëndetit mendor.
- Përgatitja e sektorit kulturor për rimëkëmbjen dhe rindërtimin e pasluftës përmes ngritjes së kapaciteteve, rritjes së inovacionit dhe mbështetjes për inovacion brenda sektorit të kulturës. Projektet e financuara nga kjo thirrje duhet të kontribuojnë në qëndrueshmërinë sociale dhe ekonomike të Ukrainës, duke u mbështetur në kulturën si mjet për të ndërtuar shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe më rezistuese.

Mënyra dhe përgatitjes dhe dorëzimit të propozim-projekteve/aplikacionit

Propozim-projektet përgatiten në pajtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentin e thirrjes: Support to the Ukrainian Cultural and Creative Sectors (CREA-CULT-2025-COOP-UA) Version 1.0, 30 October.

Lidhja e thirrjes:

https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic_details/CREA-CULT-2025-COOP-UA-1?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43251814&callIdentifier=CREA-CULT-2025-COOP-UA&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate

https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/crea/wp-call/2025/call-fiche_crea-cult-2025-coop-ua_en.pdf

Aplikacionet përpunohen dhe dorëzohen në mënyrë elektronike nëpërmjet: **Funding & Tenders Opportunity Portal (F&TP)**. Informacionet për qasje në **F&TP** mund t'i gjeni në këtë lidhje:

https://www.eacea.ec.europa.eu/grants/how-get-grant_en